



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. _____ prot.,

Datë _____._____.2025

V E N D I M

Nr.14 datë 25.09.2025

PËR

**“MIRATIMIN PËR KËSHILLIM PUBLIK TË DOKUMENTIT TË RREGULLORES
“PËR TË DHËNAT STATISTIKORE DHE FINANCIARE PERIODIKE TË
SIPËRMARRËSVE TË RRJETEVE DHE/OSE SHËRBIMEVE TË KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

Z.	Gentian Sala	Kryetar
Znj.	Edlira Dvorani	Anëtar
Z.	Lorenc Bako	Anëtar
Z.	Bleron Dokle	Anëtar
Z.	Armer Juka	Anëtar

dhe sekretare Znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 25 shtator 2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregulloren e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, si dhe ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, me propozim të Drejtorisë Rregullatore dhe Mbikëqyrjes së Tregut, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Miratimin për këshillim publik të dokumentit – “Projektregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike””

BAZA LIGJORE:

1. Nenet 12 (pika 2, germa gj), 41 dhe 44 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

2. Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë” (Ligji nr. 44/2015);
3. Rregullore për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.21, datë 7.12.2021.

K Ë S H I L L I D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Dokumenti: “Projektregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike””;
2. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
3. Relacioni shoqërues i Projektvendimit.

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N:

1. AKEP, në zbatim të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, çmon si të rëndësishme hartimin e rregullores “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike””, duke e përshtatur me kërkesat dhe parimet e ligjit nr. 54/2024 dhe harmonizim i dispozitave ekzistuese me kuadrin e ri ligjor, për të siguruar përputhshmëri dhe efektivitet rregullator;
2. AKEP, vlerëson se projekt akti administrativ rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e cila është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, do të sigurojë harmonizimin e plotë me detyrimet për mbledhjen, përpunimin dhe publikimin e statistikave;
3. Dokumenti për këshillim publik synon të përcaktojë procedurat e detajuara për raportimin e të dhënave nga operatorët, formatet e dorëzimit, afatet, verifikimin dhe korrigjimin e statistikave, si dhe mekanizmat e konsultimit me palët e interesuara;
4. Përmes nxjerrjes së dokumentit për këshillim publik, AKEP synon të rrisë efikasitetin, transparencën dhe sigurinë e të dhënave statistikore, duke përmirësuar cilësinë e analizave të tregut si dhe duke rritur rolin e mbikëqyrjes së tregut;
5. Për këtë qëllim, AKEP në zbatim të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, neni 44 dhe në përputhje me Rregulloren për Procedurat e Këshillimit Publik, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP nr.21, datë 7.12.2021, çmon si të arsyeshme nxjerrjen për Këshillim Publik të projektaktit administrativ rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”. Në këtë kontekst, publikimi i rregullores për këshillim është një hap i rëndësishëm për të siguruar përfshirjen e të gjithë aktorëve të interesuar dhe për të garantuar që rregullorja e re do të pasqyrojë nevojat reale të mbikëqyrjes së tregut.

6. Pas përfundimit të Këshillimit Publik të dokumentit me palët e interesuara dhe përfshirjes së komenteve dhe kontributit që sjell ky proces këshillimi, AKEP vijon me vendimmarrjen për miratimin e dokumentit përfundimtar të aktit rregullator “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 14, pikës 1 të nenit 15 dhe neneve 44 dhe 45 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I:

1. Të miratojë nxjerrjen për Këshillim Publik të dokumentit: “Rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike””, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Procedura e Këshillimit Publik të kryhet për një periudhë 30 ditore nga data e publikimit të dokumentit në faqen e internetit të AKEP.
3. Ky Vendim dhe Dokumenti për Këshillim Publik: “Rregullore “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike””, të publikohen në faqen e internetit të AKEP, www.akep.al.
4. Ngarkohet Drejtoria Rregullatore dhe Mbikëqyrjes së Tregut për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

Kryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Gentian Sala	Edlira Dvorani	Lorenc Bako	Bleron Dokle	Armer Juka